



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 702 Prot.

Tiranë, më 27.10 2015

**VENDIM Nr. 104, datë 21.10.2015**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.13, të datës 21.10.2015, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor, në kuadër të përgatitjes të zonës së mbrojtur arkeologjike në vendin ku janë gjetur "*Gjurmët e një dysHEMEJE me mozaik dhe rrënojat e një kishe*", në fshatin Sherishtë, komuna Qëndër-Vlorë, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor, në kuadër të përgatitjes të zonës së mbrojtur arkeologjike në vendin ku janë gjetur "*Gjurmët e një dysHEMEJE me mozaik dhe rrënojat e një kishe, fragmente muresh të një vile romake si dhe materiale të tjera qeramike*", në fshatin Sherishtë, komuna Qëndër-Vlorë, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
- II. Harta me propozimin e paraqitur si rezultat i Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor të zonës, ku janë gjetur "*Gjurmët e një dysHEMEJE me mozaik dhe rrënojat e një kishe, fragmente muresh të një vile romake si dhe materiale të tjera qeramike*", në fshatin Sherishtë, komuna Qëndër-Vlorë, të depozitohet pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës për vijimin e procedurës të shpalljes së saj "Zonë në mbrojtje".
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

